Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme



Ceiling-mounted unit[a]	
m (kg)	A_{min} (m²)
<1.224	—
1.225	0.956
1.4	1.25
1.6	1.63
1.8	2.07
2.0	2.55
2.2	3.09
2.4	3.68
2.6	4.31
2.8	5.00
3.0	5.74
3.2	6.54
3.4	7.38
3.6	8.27
3.8	9.22
4.0	10.2
4.2	11.3
4.4	12.4
4.6	13.5
4.8	14.7
5.0	16.0
5.2	17.3
5.4	18.6
5.6	20.0
5.8	21.5
6.0	23.0
6.2	24.5
6.4	26.1
6.6	27.8
6.8	29.5
7.0	31.3
7.2	33.1
7.4	34.9
7.6	36.9
7.8	38.8
7.956	40.8

Wall-mounted unit[b]	
m (kg)	A_{min} (m²)
<1.224	—
1.225	1.43
1.4	1.87
1.6	2.44
1.8	3.09
2.0	3.81
2.2	4.61
2.4	5.49
2.6	6.44
2.8	7.47
3.0	8.58
3.2	9.76
3.4	11.0
3.6	12.4
3.8	13.8
4.0	15.3
4.2	16.8
4.4	18.5
4.6	20.2
4.8	22.0
5.0	23.8
5.2	25.8
5.4	27.8
5.6	29.9
5.8	32.1
6.0	34.3
6.2	36.6
6.4	39.1
6.6	41.5
6.8	44.1
7.0	46.7
7.2	49.4
7.4	52.2
7.6	55.1
7.8	58.0
7.956	61.0

Floor-standing unit[c]	
m (kg)	A_{min} (m²)
<1.224	—
1.225	12.9
1.4	16.8
1.6	22.0
1.8	27.8
2.0	34.3
2.2	41.5
2.4	49.4
2.6	58.0
2.8	67.3
3.0	77.2
3.2	87.9
3.4	99.2
3.6	111
3.8	124
4.0	137
4.2	151
4.4	166
4.6	182
4.8	198
5.0	215
5.2	232
5.4	250
5.6	269
5.8	289
6.0	309
6.2	330
6.4	351
6.6	374
6.8	397
7.0	420
7.2	445
7.4	470
7.6	496
7.8	522
7.956	549

1 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme

1.1 Rreth dokumentacionit

- Dokumentacioni origjinal është i shkruar në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime.
- Masat paraprake të përshkruara në këtë dokument mbulojnë tema shumë të rëndësishme, ndiqi ato me kujdes.
- Instalimi i sistemit dhe të gjitha veprimet e përshkruara në manualin e instalimit dhe udhëzuesin e referimit për instaluesin duhet të kryhen nga një instalues i autorizuar.

1.1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve

RREZIK

Tregon një situatë që rezulton në vdekje ose dëmtim të rëndë.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Tregon një situatë që mund të rezultojë në goditje elektrike.

RREZIK: RREZIK DJEGIE

Tregon një situatë që mund të rezultojë në djegie për shkak të temperaturave ekstreme të ngrohta ose të ftohta.

RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

Tregon një situatë, që mund të rezultojë në shpërthim.

ALARM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në vdekje ose dëmtim të rëndë.

ALARM: MATERIAL I NDEZSHËM

KUJDES

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtim të lehtë ose të mesëm.

NJOFTIM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtimin e pajisjeve ose të pronës.

INFORMACION

Tregon këshilla të dobishme ose informacion shtesë.

Simbol	Shpjegim
	Para instalimit, lexoni manualin e instalimit dhe operimit, si dhe fletë-udhëzuesin e instalimeve elektrike.
	Para se të kryeni detyrat e mirëmbajtjes dhe servisit, lexoni manualin e shërbimit.
	Për më shumë informacion, shikoni udhërrëfyesin referues të instaluesit dhe përdoruesit.

1.2 Për përdoruesin

- Nëse nuk je i sigurt si të përdorësh njësinë, kontakto instaluesin.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e lart dhe nga personat me aftësi të reduktuara fizike, ndijore ose mendore ose nga mungesa e përvojës dhe njohurisë, nëse ata janë drejtuar ose udhëzuar lidhur me përdorimin e pajisjes në një mënyrë të sigurt dhe e kuptojnë përfshirjen e rreziqeve. Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhet të kryhet nga fëmijët pa mbikëqyrje.

ALARM

Për të parandaluar goditjet elektrike ose zjarrin:

- MOS e shpëlaj njësinë.
- MOS e përdor njësinë me duar të lagura.
- MOS vendos asnjë send që përmban ujë mbi njësi.

NJOFTIM

- MOS vendos asnjë send apo pajisje mbi njësi.
- MOS u ul, mos u ngjit dhe mos qëndro mbi njësi.

- Njësitë janë të shënuara me simbolin vijues:

Kjo do të thotë se ndoshta produktet elektrike dhe elektronike nuk përzihen me mbeturina të paklasifikuara shtëpie. MOS tento ta çmontosh vetë sistemin: çmontimi i sistemit, trajtimi i ftohësit, vajit dhe çdo pjese tjetër duhet të kryhet nga një instalues i autorizuar dhe duhet të përputhet me legjislacionin në fuqi.
Njësitë duhet të trajtohen në një objekt të specializuar trajtimi për ripërdorim, riciklim dhe rigjenerim. Duke garantuar një hedhje të rregullt të këtij produkti, ti do të ndihmosh në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Për më shumë informacion, kontakto instaluesin tënd ose autoritetin vendor.

- Bateritë janë të shënuara me simbolin vijues:

Kjo do të thotë se ndoshta bateritë nuk janë të përziera me mbeturinat e pakualifikuara të shtëpisë. Nëse poshtë simbolit është shtypur një simbol kimik, do të thotë se bateria përmban një metal të rëndë përtej një përqendrimi të caktuar.
Simbolet e mundshme kimike janë: Pb: plumb (>0,004%).
Bateritë e konsumuara duhet të trajtohen në një objekt të specializuar trajtimi për ripërdorim. Duke garantuar një hedhje të rregullt të baterive të konsumuara, ti do të ndihmosh në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

1.3 Për instaluesin

1.3.1 Këshilla të përgjithshme

Nëse nuk je i sigurt si të instalosh apo operosh njësinë, kontakto shitësin tënd.

NJOFTIM

Instalimi i papërshtatshëm ose ngjitja e pajisjeve apo aksesorëve mund të rezultojë në goditje elektrike, qark të shkurtër, rrjedhje, zjarr ose dëme të tjera për pajisjen. Përdor vetëm aksesorë, pajisje opsionale dhe pjesë rezervë prodhuar ose miratuar nga Daikin.

ALARM

Sigurohu që instalimi, testimi dhe materialet e përdorura përputhen me legjislacionin në fuqi (në krye të udhëzimeve të përshkruara në dokumentacionin Daikin).

KUJDES

Mbaj veshur pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale (doreza mbrojtëse, syze sigurie,…) kur kryen instalimin, mirëmbajtjen ose servisin e sistemit.

ALARM

Copëto dhe hidh qeset plastike të paketimit që askush, veçanërisht fëmijët, mos të luajnë me to. Rreziku i mundshëm: asfiksi.

RREZIK: RREZIK DJEGIE

- MOS e prek tubacionin e ftohësit, të ujit apo pjesë të brendshme gjatë dhe menjëherë pas përdorimit. Mund të jetë shumë i nxehtë ose shumë i ftohtë. Prit pak sa të kthehet në temperaturën normale. Nëse duhet ta prekësh patjetër, mbaj doreza mbrojtëse.
- MOS prek asnjë ftohës me rrjedhje aksidentale.

ALARM

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.

KUJDES

MOS e prek grykën hyrëse të ajrit ose fletët alumini të njësisë.

NJOFTIM

- MOS vendos asnjë send apo pajisje mbi njësi.
- MOS u ul, mos u ngjit dhe mos qëndro mbi njësi.

NJOFTIM

Punët e kryera në njësinë e jashtme realizohen më mirë në kushtet e një moti të thatë për të shmangur depërtimin e ujit.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të jetë e nevojshme pajisja me një ditar ku produkti të përmbajë të paktën: informacion mbi mirëmbajtjen, punët e riparimit, rezultatet e testimeve, periudhat e gatishmërisë,…

Gjithashtu, të paktën, duhet të ofrohet informacioni i mëposhtëm në një vend të aksesueshëm të produktit:

- Udhëzimet për fikjen e sistemit në rast emergjence
- Emri dhe adresa e zjarrfikësit, policisë dhe spitalit
- Emri, adresa dhe numrat e telefonit për ditën dhe natën për marrjen e shërbimit

Në Evropë, EN378 ofron këshillim të nevojshëm për këtë ditar.

1.3.2 Vendi i instalimit

- Siguro hapësirë të mjaftueshme rreth njësisë për kryerjen e servisit dhe qarkullimit të ajrit.
- Sigurohu që vendi i instalimit përballon peshën dhe dridhjet e njësisë.
- Sigurohu që zona të jetë e ajruar mirë. MOS blloko vrimat e ajrimit.
- Sigurohu që njësia është e niveluar.

MOS e instalo njësinë në vendet e mëposhtme:

- Në ambiente me mundësi shpërthimi.
- Në vende ku ka makineri, që lëshojnë valë elektromagnetike. Valët elektromagnetike mund të trazojnë sistemin e kontrollit dhe shkaktojnë ndërprerje të funksionit të pajisjes.
- Në vende ku ka rrezik zjarri për shkak të rrjedhjes së gazrave të djegshëm (shembull: holluesi ose benzina), fibrave të karbonit, pluhurit të ndezshëm.
- Në vende ku nxirret gaz gërryes (shembull: gazi acido sulfurik). Gërryerja e tubave të bakrit ose pjesëve të ngjitura mund të shkaktojnë rrjedhjen e ftohësit.

Udhëzime për pajisjet duke përdorur ftohësin R32

Nëse zbatohen.

ALARM

- MOS shpo dhe MOS djeg.
- MOS përdor mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit, përveç atyre që rekomandohen nga prodhuesi.
- Kini parasysh që ftohësi R32 NUK përmban aromë.

ALARM

Pajisja duhet të ruhet për të penguar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa përdorur vazhdimisht burime ndezëse (shembull: flakë të hapura, pajisje që punon me gaz ose ngrohëse elektrike) dhe përmasa e dhomës të jetë sipas specifikimit të mëposhtëm.

NJOFTIM

- MOS përdor nga e para ato lidhje që janë përdorur një herë.
- Lidhjet e krijuara në instalim mes pjesëve të sistemit të ftohësit do të jenë të aksesueshme për qëllime mirëmbajtjeje.

ALARM

Sigurohu që instalimi, servisi, mirëmbajtja dhe riparimi janë në përputhje me udhëzimet nga Daikin dhe me legjislacionin në fuqi (për shembull me rregullat kombëtare të përdorimit të gazit) dhe ekzekutohen vetëm nga persona të autorizuar.

Kërkesat për hapësirën e instalimit

NJOFTIM

- Gypat duhen mbrojtur nga dëmtimi fizik.
- Instalimi i gypave duhet të jenë në nivele minimale.

ALARM

Nëse pajisjet përmbajnë ftohës R32, atëherë sipërfaqja e dyshemesë në dhomë në të cilën instalohen, operohen dhe ruhen pajisjet duhet të jetë më e madhe se sipërfaqja minimale e dyshemesë së përcaktuar në tabelën e mëposhtme A (m^2). Kjo zbatohet për:

- njësitë e brendshme,
- njësitë e jashtme që instalohen ose ruhen brenda (shembull: kopsht dimëror, garazh, dhomë makinerish),
- gypat në hapësirat e pa ajrosura.

Përcaktimi i sipërfaqes minimale të dyshemesë

1 Përcakto ngarkesën totale të ftohësit në sistem (= ngarkesa e ftohësit nga fabrika ❶ + ❷ sasi shtesë ngarkuar ftohësit).



2 Përcakto grafikun ose tabelën për përdorim.

- Për njësitë e brendshme: A është njësia e fiksuar në tavan, mur apo qëndron në dysheme?
- Për njësitë e jashtme që instalohen ose ruhen brenda dhe tubacionet e terrenit në hapësira të pa ajrosura, kjo varet nga lartësia e instalimit:

Nëse lartësia e instalimit është…	Atëherë përdor grafikun ose tabelën për…
<1.8 m	Njësitë që qëndrojnë në dysheme
1.8≤x<2.2 m	Njësitë e fiksuara në mur
≥2.2 m	Njësitë e fiksuara në ta tavan

3 Përdor grafikun ose tabelën për të përcaktuar sipërfaqen minimale të dyshemesë. Shiko figurën 1 në brendësi të kapakut të përparmë.

m Ngarkesa totale e ftohësit në sistem
A_{min} Sipërfaqja minimale e dyshemesë
(a) Ceiling-mounted unit (= Njësi e fiksuar në tavan)
(b) Wall-mounted unit (= Njësi e fiksuar në mur)
(c) Floor-standing unit (= Njësi që qëndron në dysheme)

1.3.3 Ftohësi

Nëse zbatohet. Shikoni manualin e instalimit ose udhërrëfyesin referues të instaluesit të aplikimit tuaj për më shumë informacion.

NJOFTIM

Sigurohu që instalimi i tubacionit të ftohësit përputhet me legjislacionin në fuqi. Në Evropë, EN378 është standardi që zbatohet.

NJOFTIM

Sigurohu që tubacioni dhe lidhjet në terren nuk i nënshtrohen tensionit.

ALARM

Gjatë testimeve, KURRË mos ushtro presion më të lartë se maksimumi i lejuar mbi produktin (siç tregohet në pllakën e markës së njësisë).

ALARM

Merr masa të mjaftueshme paraprake në rast të një rrjedhjeje të ftohësit. Nëse rrjedh gazi i ftohësit, ajros menjëherë ambientin. Rreziqet e mundshme:

- Përqendrimet e tepërta të ftohësit në një dhomë të mbyllur mund të çojnë në mungesë oksigjeni.
- Nëse gazi i ftohësit mund të bjer në kontakt me zjarrin, mund të prodhohet gaz toksik.

RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

Mbyllja e valvulit – Rrjedhje e ftohësit. Nëse do të mbyllësh valvulin e sistemit dhe në qarkun e ftohësit ka rrjedhje:

- MOS përdorni funksionin e mbylljes automatike të valvulit të njësisë, me të cilin ju mund të grumbulloni të gjithë ftohësin nga sistemi në njësinë e jashtme. **Pasoja e mundshme:** Vetë-djegia dhe shpërthimi i kompresorit për shkak të ajrit që hyn në kompresorin operues.
- Përdor një sistem të ndarë rikuperimi në mënyrë që kompresori i njësisë të MOS operojë.

ALARM

Gjithmonë mbuloje ftohësin nga e para. MOS i lësho ato direkt në mjedis. Përdor një pompë vakuumi për të zbrazur instalimin.

NJOFTIM

Pas lidhjes të të gjithë tubacionit, sigurohu që nuk ka rrjedhje gazi. Përdor nitrogjen për të kapur rrjedhjen e gazit.

NJOFTIM

- Për të shmangur avarinë e kompresorit, MOS ngarko më shumë se sasia e caktuar e ftohësit.
- Kur të hapet sistemi i ftohësit, ai duhet të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ALARM

Sigurohu që në sistem të mos ketë oksigjen. Ftohësi mund të ngarkohet vetëm pas kryerjes së testimit të rrjedhjes dhe tharjes me vakuum.

- Në rast se duhet një ringarkim, referoju pllakës së markës të njësisë. Ajo konstaton llojin e ftohësit dhe sasinë e nevojshme.
- Njësia është e ngarkuar nga fabrika me ftohës dhe në varësi të madhësive dhe gjatësive të tubit disa sisteme kërkojnë ngarkim shtesë të ftohësit.
- Përdor vegla ekskluzive vetëm për llojin e ftohësit të përdorur në sistem, për të siguruar rezistencën e presionit dhe për të parandaluar hyrjen e materialeve të huaja brenda në sistem.
- Ngarko ftohësin e lëngshëm si në vazhdim:

Nëse	Atëherë
Ka prani të një tub sifoni (d.m.th. cilindri është i shënuar "Ngjitur gjendet sifoni që mbushet me lëng")	Ngarko me cilindrin në pozicion vertikal.
Nuk ka prani të tubit të sifonit	Ngarko me cilindrin përmbys.

- Hapi cilindrat e ftohësit ngadalë.
- Ngarkoje ftohësin në formë të lëngshme. Shtimi tij në formë të gaztë mund të parandalojë përdorimin normal.

KUJDES

Kur mbaron procedura e ngarkimit të ftohësit ose kur ka ndaluar, mbyll menjëherë valvulin e cisternës së ftohësit. Nëse valvuli nuk mbyllet menjëherë, presioni i mbetur mund të ngarkojë ftohës shtesë. **Pasoja e mundshme:** Sasi e pasaktë ftohësi.

1.3.4 Shëllira

Nëse aplikohet. Për më shumë informacion shiko manualin e instalimit ose udhëzuesin e referimit për instaluesin lidhur me përdorimin tënd.

ALARM

Përzgjedhja e shëllirës DUHET të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ALARM

Merr masa të mjaftueshme paraprake në rast të rrjedhjes së shëllirës. Nëse rrjedh shëllira, ajros menjëherë zonën dhe kontakto shitësin tënd lokal.

ALARM

Temperatura e ambientit brenda njësisë mund të shkojë shumë më lartë se ajo e dhomës, p.sh. 70°C. Në rast të një rrjedhjeje të shëllirës, pjesët e nxehta brenda njësisë mund të krijojnë një situatë të rrezikshme.

ALARM

Përdorimi dhe instalimi i aplikimit DUHET të pajtohet me sigurinë dhe masat paraprake mjedisore të specifikuara në legjislacionin në fuqi.

1.3.5 Uji

Nëse aplikohet. Për më shumë informacion shiko manualin e instalimit ose udhëzuesin e referimit për instaluesin lidhur me përdorimin tënd.

NJOFTIM

Sigurohu që cilësia e ujit përputhet me direktivën 98/83 EC të BE-së.

1.3.6 Elektriket

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

- FIK të gjithë furnizimin me energji elektrike para se të heqësh kapakun e kutisë së çelësit, duke lidhur instalimet elektrike ose duke prekur pjesët elektrike.
- Shkëput furnizimin me energji elektrike për më shumë se 1 minutë, dhe mat voltazhin në pikat fundore të kondensatorëve të qarkut kryesor ose përbërësit elektrikë para se të kryesh servisin. Voltazhi DUHET të jetë më pak se 50 V DC para se të mund të prekësh përbërësit elektrikë. Për vendndodhjen e pikave fundore, shiko skemën e instalimeve elektrike.
- MOS i prek përbërësit elektrikë me duar të lagura.
- MOS e lër njësinë të pambikëqyrur kur hiqet kapaku i servisit.

ALARM

Nëse nuk është instaluar në fabrikë, atëherë në instalimet e fiksuara elektrike do të instalohet një çelës kryesor ose mënyra të tjera për shkëputje, duke pasur një ndarje kontakti në të gjitha polet ku ofrohet shkëputje e plotë sipas kushtit të kategorisë III për mbitensionin.

ALARM

- Përdor VETËM tela bakri.
- Sigurohu që instalimet elektrike në terren përputhen me legjislacionin në fuqi.
- Të gjitha instalimet elektrike në terren duhet të kryhen në përputhje me planin e tyre të ofruar së bashku me produktin.
- KURRË mos i ngjesh kabllot e lidhura dhe sigurohu që të mos bien në kontakt me tubacionet dhe buzët e mprehta. Sigurohu që nuk përdoret presion i jashtëm në lidhjet fundore.
- Sigurohu që të instalosh instalimet elektrike të tokëzimit. MOS e tokëzo njësinë në një tub utiliteti, amortizator apo në tokëzimet e telefonit. Tokëzimi i papërfunduar mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Sigurohu të përdorësh një qark të dedikuar energjie. KURRË mos përdor furnizim me energji elektrike të ndarë nga një pajisje tjetër.
- Sigurohu të instalosh siguresat e kërkuara ose çelësat elektrikë.
- Sigurohu të instalosh një mbrojtës tokëzues ndaj rrjedhjes. Mosrealizimi i tij mund të shkaktojë goditje elektrike ose zjarr.
- Kur instalon mbrojtësin tokëzues ndaj rrjedhjes, sigurohu që përshtatet me inverterin (rezistent ndaj zhurmës elektrike me frekuencë të lartë) për të shmangur hapjen e panevojshme të mbrojtësit tokëzues ndaj rrjedhjes.

NJOFTIM

Masat paraprake kur kryen instalimet elektrike të energjisë:

- Mos lidh instalime elektrike të trashësive të ndryshme me bllokun fundor të energjisë (shtendosja në instalimet elektrike të energjisë mund të shkaktojnë nxehje jonormale).
- Kur lidh instalimet elektrike, që është e njëjta trashësi, bëj siç tregohet në figurën më poshtë.

- Për instalimet elektrike, përdor telin e përcaktuar të energjisë dhe lidhe fort, pastaj sigurohu të pengosh presionin e jashtëm që të ushtrohet mbi qarkun fundor.
- Përdor një kaçavidë të përshtatshme për shtrëngimin e vidhave fundore. Një kaçavidë me një kokë të vogël dëmton kokën dhe e bën të pamundur shtrëngimin e duhur.
- Shtrëngimi i tepërt i vidhave fundore mund t'i thyejë ato.

Instalo kabllot e energjisë të paktën 1 metër larg televizorëve ose radiove për të penguar interferencën. Në varësi të valëve të radios, një distancë prej 1 metri mund të mos mjaftojë.

ALARM

- Pas mbarimit të punëve elektrike, konfirmo që çdo përbërës dhe terminal elektrik brenda kutisë së përbërësve elektrikë është i lidhur në mënyrë të sigurt.
- Sigurohu që të gjithë kapakët të jenë të mbyllur para se të ndezësh njësinë.

NJOFTIM

Zbatohet vetëm nëse furnizimi me energji elektrike është me tre faza, dhe kompresori ka një metodë fillimi me NDEZJE/FIKJE.

Nëse ekziston mundësia e fazës së kthimit pas një bllokimi momental dhe energjia ndizet dhe fiket kur produkti është në përdorim, ngjit lokalisht një qark mbrojtës të fazës së kthimit. Vënia në punë e produktit në fazën e kthimit mund të thyejë kompresorin dhe pjesë të tjera.

1.4 Fjalori

Shitësi

Shpërndarësi i shitjeve për produktin.

Instaluesi i autorizuar

Personi me aftësi teknike, i cili është i kualifikuar për të instaluar produktin.

Përdoruesi

Personi që është zotëruesi i produktit dhe/ose operon produktin.

Legjislacioni në fuqi

Të gjitha direktivat, ligjet, rregullat dhe/ose kodet ndërkombëtare, evropiane, kombëtare dhe vendore, që lidhen dhe përdoren për një produkt ose domen të caktuar.

Kompania e shërbimit

Kompania e kualifikuar që mund të kryejë ose bashkërendojë shërbimin e kërkuar të produktit.

Manuali i instalimit

Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen.

Manuali i përdorimit

Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar përdorimin e tij.

Aksesorë

Etiketa, manuale, fletëudhëzues dhe pajisje, që dorëzohen me produktin dhe që kanë nevojë të instalohen në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Pajisjet opsionale

Pajisje prodhuar ose miratuar nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Furnizim në terren

Pajisje prodhuar nga Daikin, që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

4P370474-1 F 00000000

Copyright 2015 Daikin

DAIKIN INDUSTRIES CZECH REPUBLIC s.r.o.
U Nové Hospody 1/1155, 301 00 Plzeň Skvrňany, Czech Republic

DAIKIN EUROPE N.V.
Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

4P370474-1F 2017.02